

KËRKESË
Nr. 304, datë 15.7.2021

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë shpall kërkesën për shpronësim për interes publik të pasurive, pronë private, që preken nga zbatimi i projektit “Përmirësimi i furnizimit me ujë të pijshëm për qytetin e Roskovecit”.

Subjekti kërkues i këtij projekti është Bashkia Roskovec.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim për pasuritë, pronë private, të cilat do të kompensohen sipas vlerësimit paraprak të llogaritur, bazuar në VKM-në nr. 89, datë 3.2.2016, “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”, dhe në VKM-në nr. 138, datë 23.8.2000, “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive, pronë private, që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, të ndryshuar, sipas tabelës paraprake bashkëlidhur.

Referuar pikës 2, të nenit 15, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet publike dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, keni të drejtë që, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga data e publikimit të kërkesës në Fletoren Zyrtare të paraqitni pretendimet tuaja, nëse keni, pranë Bashkisë Roskovec, si dhe në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë.

Vlera totale paraprake e shpronësimit është 971,548.75 (nëntëqind e shtatëdhjetë e një mijë e pesëqind e dyzetë e tetë pikë shtatëdhjetë e pesë) lekë.

KRYETAR I KOMISIONIT TË POSAÇËM
TË SHPRONËSIMEVE
Erlis Hereni

Lista paraprake e pronarëve, pronë private, që shpronësohen nga realizimi i projektit
 “Përmirësimi i furnizimit me ujë të pijshëm për qytetin e Roskovecit”

Nr .	Emë r Atës Mbiemë r	Nr. i pasuris ë	ZK	Sipërfaqja e parcelës sipas kartelës së pronësisë m ²	Sip. e tokës së prekur m ²	Çmimi lekë/m ²	Vlera e tokës	Lloji i kulturës bujqësore	Vlera e kulturës/dy	Vlera në lekë e kulturës	Vlera totale lekë	Shënime sqaruese
1	Defrim Barjam Hoxha	63/36	3767	4759	1074	269	288906	Misër	17125	18392.25	307298	Certifikatë pronësie
2	Hekuran Bajram Mamo	64/27	3767	3257	1074	269	288906	Misër	17125	18392.25	307298	Certifikatë pronësie
3	Aqif Caush Hoxha, Emine Shaip Hoxha	66/4	3767	5455	1284	269	345396	Tërfil	9000	11556	356952	Certifikatë pronësie
Vlera totale paraprake					3432.0		923208			48341	971549	

1. Vlerësimi për kulturën bujqësore është kryer bazuar në VKM-në nr. 138, datë 23.3.2000.
2. Vlerësimi i pasurisë së llojit “tokë arë” është kryer në VKM-në nr. 89, datë 3.2.2016.